



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 68 datë 01.07 2026

**PËR EMERTIMIN E NJË RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË PËRMET.
ME EMRIN: DHIMITËR LIÇI (PAS VDEKJES)**

Në mbështetje të Nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja "b" nënpika 1.7 shkronja "b" neni 54 shkronja II" dhe nenit 55 pika 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, , veçanërisht dispozitat që përcaktojnë kompetencat e këshillit bashkiak për administrimin e çështjeve me interes vendor dhe emërtimin e hapësirave publike; neni 3 të ligjit 9270 datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave" të ndryshuar, kërkesa e paraqitur nga një grup intelektualësh të qytetit Përmet mbi bazën e relacionit të paraqitur si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Përmet,

V E N D O S I:

1. Miratimin e emërimit me emrin **DHIMITËR LIÇI** (pas vdekjes) të rrugës, Sipas fragmentit të hartës së paraqitur bashkëlidhur këtij Vendimi si më poshtë:
"Segmenti nga kryqëzimi i rrugës për në Këlcyrë deri tek kryqëzimi i rrugës së Çarçovës". Me kordinata sipas KRGJSH, pika e fillimit: E 530205.73 N 4455630.17, pika e mbarimit E 530457.17 N 4455617.15.
2. Çdo Vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1, të këtij vendimi shfuqizohet.
3. Ngarkohen Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Ekonomise Zhvillimit Buqësisë e Turizmit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55 pika 6 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

Në mungesë dhe me porosi
Nënkryetari i Këshillit të Bashkisë Përmet
Agim ANDONI

